



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	04.03.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Shkurt

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 03.02.2025 deri me 28.02.2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit shkurt, kemi intensifikuar aktivitetet dhe përgatitjet për realizimin e projekteve që do të zhvillohen në muajt në vijim,

Që në fillim të muajit, kemi nënshkruar një marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me organizatën IADK. Ky bashkëpunim ka për qëllim fuqizimin e grave, të rinjve dhe fermerëve në zonat rurale, duke i pajisur ata me mjete dhe njohuri për të përmirësuar kapacitetet e tyre prodhuese. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, fermerët do të përfitojnë grante, trajnime profesionale dhe mbështetje teknike, duke krijuar kushte më të mira për zhvillim dhe qëndrueshmëri ekonomike.

Paralelisht, kemi vijuar me monitorimin e procesit të montimit të serave në terren, të cilat po montohen te secili përfitues në përputhje me afatet dhe planifikimet e paracaktuara. Ky proces ka ecur me ritme të mira, duke siguruar që çdo përfitues të ketë gjërat e nevojshme për të rritur prodhimin dhe cilësinë e të mbjellurave.

Në të njëjtën kohë, kemi qenë të angazhuar në përgatitjen e thirrjeve për subvencionimin e fermerëve me mekanizma të ndryshëm bujqësorë. Synimi është të lehtësojmë proceset e punës dhe të rrisim produktivitetin në të gjitha nivelet në këtë sektor. Po ashtu, kemi përgatitur thirrjen për aplikim në sektorin e blegtorisë, duke synuar mbështetjen e prodhuesve të qumështit përmes subvencionimit të sasisë së prodhuar, në mënyrë që të stimulojmë rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit vendas.

Më 24 shkurt është mbyllur afati për aplikim për cilësinë dhe sasinë e qumështit në kuadër të skemave të Ministrisë së Bujqësisë. Aplikacionet e pranuar do të dorëzohen për shqyrtim dhe vlerësim nga ministria, me qëllim që fermerët të marrin mbështetjen e merituar në kohë dhe pa vonesa.

Duke marrë parasysh afrimin e periudhës së hapjes së Programit për Pagesa Direkte dhe duke vlerësuar numrin e lartë të fermerëve që aplikojnë për subvencione për sipërfaqe, Drejtoria e Bujqësisë ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e shërbimeve. Është rritur numri i stafit me qëllim për të garantuar një proces më të shpejtë dhe efikas, duke minimizuar kohën e pritjes dhe duke ofruar shërbime më cilësore për çdo aplikues.

Për më tepër, kemi vazhduar me vizita të rregullta në terren, për të kuptuar nga afër sfidat dhe nevojat specifike të fermerëve. Këto vizita kanë shërbyer si një mundësi e vlefshme për të identifikuar dhe adresuar në kohë vështirësitë, duke ndihmuar fermerët me zgjidhje praktike dhe mbështetje nga drejtorati i bujqësisë.